

# IME MË ËSHTË VRASËSE

**Nga**

**Isabel Cruz Liljegren**

## PERSONAZHET

ELIASI – djalë 16 vjeç

NËNA 15 – vajzë 15 vjeç, versioni i NËNËS në moshë të re

ULLI - vajzë 15 vjeç

NËNA - grua 45 vjeç

...nënkupton një rresht që vazhdon ta tensionojë situatën.

[] tregon fjalë që mungojnë ose që nuk thuhet me zë.

-nënkupton një pëgjigje pasuese që jepet menjëherë pa asnjë pushim.

*Peizazh zanor i një fshati. Është verë. ELIASI po regjistron.*

ELIASI

Po mbylla sytë, e di saktësisht ku ndodhem. Zogj, pika shiu që bien drejt e mbi bar nga çatia, edhe pse shiu ka një copë herë të mirë që ka pushuar. Parketi prej druri kërcet, sepse ime më vërtitet nëpër kuzhinë. Ora, era, një mizë dhe lloçitja e largët e Liqenit të Errët. Unë regjistroj, vazhdimisht, që të mund të rikthehem sërish në kohë, pa më lëvizur trupi. Është hera e fundit që vij këtu, në shtëpinë e gjyshes, se këtu mund të vij veç me time më dhe shumë shpejt ajo do të përfundojë në burg. Për shkakun tim. Unë quhem ELIAS, jam 16 vjeç dhe ime më është vrasëse. Mbani vesh.

*ELIASI shtyp butonin që vë kasetën të luajë në magnetofon. Një përzierje e shkurtër muzike nga fillimi i viteve '90. Muzika ndalet beftë dhe fillon një regjistrim. NËNA 15 qesh. ULLI tingëllon serioze.*

NËNA 15

Ulli, thuaje prapë.

ULLI

Si?

NËNA 15

Jepi, thuaje prapë.

ULLI

Pse? Po regjistron?

NËNA 15

Jo, do vija pak muzikë, po më duket se nuk punon. Shpresoj të marr një të ri nesër.

*NËNA 15 shtyp butonat e magnetofonit. Regjistrimi ndalon dhe fillon prapë.*

NËNA 15

Hëm, po. (ULLIT) Pra, ti ke frikë nga unë?

ULLI

Nuk vij nesër.

NËNA 15

Po kam ditëlindjen.

*ELIASI shtyp butonin e ndaljes së magnetofonit.*

ELIASI

Kjo është një kasetë e regjistruar në vitin 1991. Kështu shkruhet në kapak. Regjistrimin e ka bërë ime më. Të nesërmen do të mbushte 15 vjeç dhe shoqja e saj, Ulli, vdiq atë natë, në prag të ditëlindjes. Këtë regjistrim e gjeta një natë në një kuti me sende të fëmijërisë së mamasë, rrasur lart në dollapin e dhomës së saj të vjetër. Kutia kishte mbishkrimin "kasetë të përziera" a diçka të tillë. Kur ishte gjallë, gjyshja më tregoi për Ullin, Ulrikën, shoqen e ngushtë të mamasë, që s'di si shkoi e u mbyt në Liqenin e Errët. Tani e kuptoj pse mami nuk ka dashur kurrë të flasë për të. Nuk ishte vetëvrasje. Tingujt flasin vetë. Diçka do të ndodhë.

*ELIASI shtyp butonin e luajtjes së kasetës në magnetofon.*

ULLI

Hej, është vonë. Akoma s'ka ardhur mamaja jote?

NËNA 15

Po bën kështu prej asaj që ndodhi herën e fundit. Prandaj ke frikë.

ULLI

S'duhet ta kishe bërë. Dhe unë s'duhet...

NËNA 15

*(e ndërpret)* Pra, jam e ligë?

ULLI

S'jemi të mira për njëra-tjetrën.

NËNA 15

Jemi të pushtuara nga demonë?

ULLI

*(pëshpërit)* Jo... Ç'po bën? *(e ndal pëshpërimën)* Kjo duhet të jetë hera e fundit që takohemi.

NËNA 15

Oh, të jap fjalën. Hera e fundit.

ULLI

Ti do të më ma hash kokën mua.

NËNA 15

Shët...

ULLI

*(pëshpërit) Ç'po më bën? Jo... S'marr dot... frymë...*

*Hungërima dhe tinguj frymëmarrjeje të zorshme / gulçima që mund të interpretohen sikur NËNA 15 po e mbyt a po e vret disi ULLIN.*

ULLI

*(rëndë) Jo... Ah... O Zot! Ndalo... S'marr dot frymë... Ah! Më lësho, më... më... Ah... Ah...*

*Magnetofoni bie përdhe dhe regjistrimi ndërpritet befas, pak para se tingujt e vrasjes të kapin kulmin. Kasetja vazhdon të gumëzhijë e të fërshëllejë mekur në sfond. (Tingulli i një ngjarjeje të regjistruar, po ajo që po ndodh, ka ndodhur larg magnetofonit. Ose volumi është më i ulët, ose ka shumë gumëzhima.)*

ELIASI

Kaq ka. Dëgjohe vetë tingulli i ujit të errët. Mami duhet ta ketë tërhequr trupin gjer atje [atë natë].

NËNA

*(e ndërpret) Kjo kujton se ndodhi?*

ELIASI

Sa kohë ke që rri aty?

NËNA

S'e kisha idenë që... që ajo...

*Nga kasetja dëgjohe një murmurimë.*

ELIASI

Pse e vrave?

NËNA

Ç'është ajo që lëviz atje?

ELIASI

Ajo? Ah, e ke për valëzimin në ekran. Harrova të shuaj magnetofonin dhe tani po regjistron drejt e në laptop. Po, hej... prit...

*ELIASI shkruan diçka në tastierë.*

ELIASI

Ka edhe diçka tjetër këtu.

*ELIASI shtyp butonin e ndalimit në magnetofon. Murmurima pushon.*

ELIASI

Prit, po i ngre zërin...

ELIASI *shtyp në kompjuter dhe ngre zërin. Dëgjohej një zhurmë, pastaj një zë, që veshi zor se e kap.*

NËNA

Ç'ishte ajo?

ELIASI

Dukej si... Prit ta ngre edhe pak.

ELIASI *shtyp në kompjuter.*

ELIASI

Tani, mbase.

ELIASI *shtyp butonin për të luajtur. Tingulli dëgjohej më i qartë dhe është zëri i qartë, po prej fantazme i ULLIT.*

ULLI

Po fle? *(pauzë)* Më dëgjon? *(pauzë)* Më fal që ta prisha ditëlindjen. Unë... *(pauzë)* të dua. Unë *(nuk dëgjohej)*

*Zëri i vajzës zhduket. Kaseta buçet me fërshëllimat e shiritit. NËNA mbushet thellë me frymë. ELIASI shtyp butonin e shuarjes. Tingulli ndalet.*

ELIASI

Kujtoja se Ulli kishte vdekur në prag të ditëlindjes tënde.

NËNA

S'mund [të jetë e vërtetë]. Ajo vdiq.

ELIASI

Si mund ta kishte prishur ditë... [lindjen]?

NËNA

Më vjen keq, zemër, e bisedojmë më vonë... unë...

NËNA *del, mbyll derën.*

ELIASI

Duhet të çlodhem pak.

ELIASI *e ndal regjistrimin. Kalon kohë. Tinguj shiu. ELIASI fillon të regjistrojë sërish.*

ELIASI

Po bie shi, prapë. *(pauzë)* Me mamin s'folëm kurrë më për atë që dëgjuam. Mbase ishte shumë e madhe, e pazakontë dhe pak si e paperceptueshme. Si mund të flasësh për gjëra që nuk i kupton. Për gjëra që s'mendoje se ekzistonin, po ja që ekzistojnë? *(pauzë)* Mbase nuk duhet të flasësh për to, as t'i kuptosh, ndonjëherë mjafton veç ta hapësh mendjen dhe thjesht... të dëgjosh.

ELIASI *shtyp në kompjuter. Zëri prej fantazme i ULLIT dëgjohej sërish (regjistrimi i mëparshëm).*

ULLI

Unë... *(pauzë)* Të dua. Unë *(nuk dëgjohej)*

*Zhurma e shiritit të kasetës.*

FUND